



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

Nr. .... Prot.  
(Lutemi referojuni në rast përgjigje)

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2015

**RAPORT MONITORIMI PËR VITIN 2014**

Në zbatim të VKM-së nr.1013, datë 10.12.2010, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", buxhetit të miratuar me ligjin nr.185, datë 28.12.2013 "Për buxhetin e vitit 2014", fondet e buxhetit të miratuara për institucionin tonë për vitin 2014 janë në shumën 118.928.166 lekë.

**Agjencia Kombëtare e Provimeve për vitin 2014, administroi dhe menaxhoi fondet buxhetore, sipas programit të miratuar, si më poshtë:**

- |  |                 |
|--|-----------------|
| 1. Programi "Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm". Kapitulli (1).... | 98.928.166 lekë |
| 2. Programi "Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm". Kapitulli (5).... | 20.000.000 lekë |

**Fondet e miratuara për AKP në Programin 09230 "Arsimi i Mesëm i përgjithshëm", sipas grup artikujve janë sa vijon:**

Fondet për shpenzimet korente kapitulli (1) ku përfshihen fondet për shpenzime personeli si dhe fondet për shpenzime për blerje materiale dhe shërbime arrijnë në kuotën 98.928.166 lekë ose 83.2 % të fondeve të miratuara për vitin 2014.

- Fonde për shpenzime për personelin për vitin 2014;** ishin planifikuar në shumën 41.210.731 lekë, e cila garantoi mbulimin e pagave dhe sigurimeve shoqërore të numrin aktual të punonjësve të institucionit prej 36 punonjës. Shpenzimet e personelit të miratuar për vitin 2014 zënë rreth 41,6% e buxhetit të institucionit. Këto fonde janë realizuar në shumën 38.022.957 lekë ose në masën 92.2%.
- Fondet për shpenzimet korente/operative për blerje mallra dhe shërbime;** Fondet e miratuara për mbulimin e shpenzimeve për blerjen e mallrave dhe shërbimeve nga të tretë ishin planifikuar në shumën 56.250.000 lekë ose 56.9% e buxhetit të miratuar për vitin 2014. Zërat kryesorë në këtë grup artikull të shpenzimeve të tjera korente janë, shpenzimet për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të domosdoshme për realizimin e Maturës Shtetërore 2014, shpenzimet për energji elektrike, ujë, telefon, internet, posta etj. Peshën me të madhe të shpenzimit në këtë grup artikull e zënë shpenzimet për honorare në shumën 40.271.690 lekë, me të cilën janë likuiduar detyrimet e Maturës Shtetërore 2014. Në këtë shumë për honorare përfshihet dhe likuidimi i një pjese të detyrimeve të trashëguara nga viti 2013, honorare për të drejtën e autorit, për bashkëpunëtorët e Drejtorisë së Provimeve të Shtetit e cila ishte në shumën 14.800.000 lekë. Këto fonde janë realizuar në shumën 56.133.794 lekë ose në masën 99.8%.
- Fondet për transferta në buxhetet familjare dhe individët;** Fondet e miratuara për mbulimin e detyrimit institucional ndaj gjashtë punonjësve të larguar nga puna gjatë vitit 2014, ishin planifikuar në shumën 1.336.442 lekë ose 1.3% e buxhetit të miratuar për vitin 2014. Këto fonde janë realizuar në shumën 1.336.442 lekë ose në masën 100%.
- Fondet për shpenzimet për investime;** Fondet e miratuara për shlyerjen e detyrimit ndaj "Sinteza & Co" të trashëguar nga viti 2012 për blerje pajisje kompjuterike, (diference fature) në shumën 130.933 lekë.

Fondet për shpenzimet korente kapitulli (5) ku përfshihen fondet për shpenzime për blerje materiale dhe shërbime arrijnë në kuotën 20.000.000 lekë ose 16.8 % të fondeve të miratuara për vitin 2014.

e) **Fondet për shpenzimet korente/operative për blerje mallra dhe shërbime;** Fondet e miratuar për mbulimin e shpenzimeve për blerjen e mallrave dhe shërbime nga të tretë ishin planifikuar në shumën 20.000.000 lekë ose 16.8% e buxhetit të miratuar për vitin 2014. Zëri kryesorë dhe i vetëm në këtë grup artikull të shpenzimeve të tjera korente janë shpenzimet për honorare në shumën 20.000.000 lekë, me të cilën janë likuiduar diferenca e detyrimeve të Maturës Shtetërore 2014, të pa mbuluara nga kapitulli (1) si dhe likuidimi i detyrimeve të vitit 2014, për honorare për të drejtën e autorit, për bashkëpunëtorët e Drejtorisë së Provimeve të Shtetit. Këto fonde janë realizuar në shumën 20.000.000 lekë ose në masën 100%.

Realizimi i fondeve buxhetore sipas grup artikujve për vitin 2014 rezulton si më poshtë:

Realizimi i fondeve buxhetore për shpenzime për personelin	92.2 %
Realizimi i fondeve buxhetore për shpenzimet korente/operative	99.8 %
<u>Realizimi i fondeve buxhetore për shpenzimet korente/operative kap.5</u>	<u>100.0 %</u>
Realizimi i fondeve buxhetore total	<b>97.2 %</b>

Nr	Emri i programit	Buxheti i miratuar	Struktura	Realizimi vjetor 2014			
		2014 (mijë lekë)	Ne %	Ne mijë /lekë	Struktura ndaj buxh	ne % total	Struktura ne % ndaj realizim
1	Arsimi i mesëm i përgjithshëm kapitulli 1	98,928.2	83.2	95,624.2	96.7		82.7
2	Arsimi i mesëm i përgjithshëm kapitulli 5	20,000.0	16.8	20,000.0	100.0		17.3
3	<b>Totali</b>	<b>118.928.2</b>	<b>100.0</b>	<b>115,624.2</b>	<b>99.6</b>		<b>100.0</b>

Krahas realizimit të fondeve buxhetore, në zbatim të VKM nr.78, datë 08.02.2006 "Për krijimin e maturës shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike", Ligjit nr.10171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, VKM nr.810, datë 10.11.2011 "Për përcaktimin e tarifave për provimet e shtetit" AKP për vitin 2014 ka realizuar të ardhura në shumën 104.187.050 lekë.

Nga këto të ardhura janë përdorur nga institucioni shuma 20.000.000 lekë, sipas limiteve të akorduara, ose në masën 19.2% e tyre dhe janë derdhur në buxhetin e shtetit shuma 84.187.050 lekë ose në masën 80.8% e tyre.

#### Objektivat kryesore:

- ✓ Objektivi 1). Rritja e mëtejshme e cilësisë së Provimeve të Lirimit dhe Maturës Shtetërore, dhe Provimeve të Shtetit me qëllim që, të përafrohemi standardeve të vendeve të BE.
- ✓ Objektivi 2). Hartimi, shumëfishimi i testeve për, pranimet në Akademinë e Policisë, Provimet e Lirimit, shkollës së mesme me kohë të shkurtuar, Olimpiadën Kombëtare për klasat e nënta dhe shkollën e mesme dhe Maturën Shtetërore.
- ✓ Objektivi 3). Administrimi i procesit të provimeve, korrigjimeve, ri korrigjimeve, për të dyja sesionet deri në shpalljen e rezultateve të Maturës Shtetërore.
- ✓ Objektivi 4). Realizimi i projektit "Matura Shtetërore Online", aplikimi online i formularit A2.
- ✓ Objektivi 5). Vlerësimi i testeve të Maturës Shtetërore dhe shpallja e rezultateve sipas standardit "meritë preferencë".
- ✓ Objektivi 6). Realizimi i vlerësimit kombëtar për klasat e treta dhe të pesta të arsimit nëntë vjeçar në lëndët gjuhë shqipe, matematikë dhe shkencat natyrore.

- ✓ Objektivi 7). Realizimi i marrëveshjes të MAS me OECD për vlerësimin ndërkombëtar PISA 2012 dhe 2015.
- ✓ Objektivi 8). Realizimi i Provimeve të shtetit me dy sesione në vit për rreth 10 profesione të rregulluara.
- ✓ Objektivi 9). Realizimi i zhvillimit profesional të punonjësve të institucionit.
- ✓ Objektivi 10). Hartim të udhëzuesve të ndryshëm dhe trajnime të vlerësuesve, administratorëve dhe punonjësve të IT & statistikës.
- ✓ Objektivi 11) Ruajtja dhe administrimi në formë elektronike të gjithë të dhënave të procesit, që nga fillimi dhe deri në regjistrimin përfundimtar të studentëve.
- ✓ Objektivi 12) Kontributi në hartimin e rregulloreve dhe udhëzimeve të provimeve kombëtare dhe të pranimeve.
- ✓ Objektivi 13) Njëpërmjet Portalit të Maturës Shtetërore online ndërtimi dhe administrimi i bazës së të dhënave shkollore dhe të maturës shtetërore për kryerjen e procesit të pranimit të studentëve në institucionet e arsimit të lartë të vendit sipas parimit meritë preferencë.
- ✓ Objektivi 14) Shpallja e listave fituese në programet e studimit të ofruara nga IALP-të dhe merr informacione nga këto të fundit për regjistrimet përfundimtare të studentëve.
- ✓ Objektivi 15) Administrimi i bazës së të dhënave të Institucioneve të Arsimit të Lartë Publik dhe Privat si dhe procesin e dhënies së numrave të matricullimit për të gjithë studentët që ndjekin studimet e larta.
- ✓ Objektivi 16) Përgatitja dhe shpërndarja e Librit të Transparencës.
- ✓ Objektivi 17) Mirë-administrimi i rrjeteve informatike, serverave si dhe sistemeve informatike softuerike.
- ✓ Objektivi 18) Përgatitja e bazës elektronike të të dhënave të maturanëve kandidatë me të gjithë elementët e nevojshëm të gjeneraliteteve, rezultateve në provimet e Maturës Shtetërore, mesataren e shkollës së mesme etj.

#### **Arritjet :**

- ✓ Objektivat e sipërpërmendura janë realizuar 100%.
- ✓ Vazhdon konsolidimi i cilësisë së Maturës Shtetërore, e cila konsiston në 5 provime për rreth 42 -45 mijë maturanë (3 provime të detyruara dhe 2 provime me zgjedhje).
- ✓ Nxënësit që përfunduan me sukses Maturën Shtetërore gjatë vitit 2014 u pajisen me diplomë; çdo diplomë përmban të njëjtin numër identifikues ID të nxënësit, që ka dhënë provimin e Maturës Shtetërore, dhe që regjistrohet në sistemin e të dhënave pranë AKP-së. Ky është një standard i ri cilësor që e përfron shumë Maturën shqiptare me atë të vendeve të tjera, rrit cilësinë e studentëve në hyrje, për pranim në shkollën e lartë, ndikon drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së studimeve universitare dhe lehtëson pranimin e studentëve shqiptarë në shkollat e larta të huaja dhe mobilitetin e studentëve në tërësi.
- ✓ Vazhdon konsolidimi i cilësisë së Provimeve të Shtetit për profesionet e rregulluara. Agjencia Kombëtare e Provimeve organizoi Provimin e Shtetit për degët Mjekësi dhe Farmaci etj, nëpërmjet teknologjisë dixhitale dhe në përputhje me standardet evropiane. Sesionet e provimit të shtetit përfunduan me sukses të plotë dhe me besueshmëri të lartë tek të interesuarit. AKP zhvillon e implementon një standard të mirëfilltë ndërkombëtar të provimit tërësisht dixhitale, me zero korrupsion dhe transparencë maksimale.

#### **Arritjet të detajuara:**

##### **MSH 2013, Sesioni I:**

- ✓ Studimi i treguesve të pyetjeve të testeve të Maturës Shtetërore 2013.
- ✓ Përcaktimi i tabelës së specifikimeve për testet në Maturën Shtetërore 2014.
- ✓ Ngritja e grupeve të bashkëpunëtorëve të hartimit të fondit e pyetjeve dhe trajnimi i tyre.

- ✓ Tryeza debati me mësues e specialistë.
- ✓ Mbledhja e të dhënave të maturantëve për provimet e MSH 2014, formularët A1,A1Z.
- ✓ Hedhja në sistem e koeficienteve të shkollave dhe lëndëve sipas programeve të studimit.
- ✓ Konfirmimi dhe pastrimi i të dhënave (nga pasaktësitë e të dhënave personale deri në heqjen nga databaza të mbetësve të vitit).
- ✓ Organizimi i ambienteve dhe pajisjeve teknike për realizimin e sesionit I.
- ✓ Koordinimi me shërbimin e policisë për sigurimin e objektit.
- ✓ Trajnimi i personave të autorizuar nga MAS si persona të autorizuar për përzgjedhjen e pyetjeve të testit.
- ✓ Hedhja në sistem e rezultateve të ekuivalentuar nga MAS(maturantë të ardhur nga jashtë shteti, etj).
- ✓ Hartimi i testeve të Maturës Shtetërore.
- ✓ Hartimi i skemave të përgjigjeve dhe vlerësimit me pikë të përgjigjeve, Sesioni I.
- ✓ Hartimi i udhëzuesve për vlerësuesit e testeve dhe trajnimi i tyre.
- ✓ Vlerësimi i testeve për secilin nga provimet D1,D2,Z1,Z2(Z3), Sesioni I.
- ✓ Monitorimi i qendrave të vlerësimit me përfaqësues të AKP.
- ✓ Mbajtja e evidencave të vlerësuesve, operatoreve dhe drejtuesve teknikë të vlerësimit.
- ✓ Hedhja në format elektronik të të dhënave të vlerësimit të çdo testi.
- ✓ Shpallja e rezultateve dhe përcjellja zyrtare e rezultateve.
- ✓ Kthimi i përgjigjeve të ankimit të rezultateve të secilit prej provimeve.
- ✓ Koordinimi me MAS dhe me Postën Shqiptare për shpërndarjen e testit në DAR/ZA, grumbullimin e testeve në AKP e më pas shpërndarjen e planifikuar në pesë qendrat e vlerësimit.
- ✓ Prezantimi në median e shkruar dhe vizive i të gjitha veprimtarive MSH 2014.
- ✓ Popullimi i vazhdueshëm i Site-it të AKP me informacionet e nevojshme.
- ✓ Printimi i diplomave.

### **MSH 2013, Sesioni II:**

- ✓ Organizimi i ambienteve dhe pajisjeve teknike për realizimin e sesionit II.
- ✓ Koordinimi me shërbimin e policisë për sigurimin e objektit.
- ✓ Trajnimi i personave të autorizuar nga MAS si persona të autorizuar për përzgjedhjen e pyetjeve të testit.
- ✓ Mbledhja e të dhënave nga DAR/ZA për maturantët pjesëmarrës në sesionin II.
- ✓ Hedhja në sistem e rezultateve të ekuivalentuar nga MAS (maturantë të ardhur nga jashtë shteti, etj).
- ✓ Hartimi i testeve të Maturës Shtetërore, Sesioni II.
- ✓ Vlerësimi i testeve dhe dhënia e përgjigjeve sipas çdo DAR/ZA.
- ✓ Integrimi i të dhënave të sesioni II në databazën e përgjithshme për A3.
- ✓ Shqyrtimi i ankesave dhe dhënia e përgjigjeve.

Në mbyllje të Maturës Shtetërore 2014, të dy sesionet, u krye analiza e rezultateve të saj. Nëpërmjet “Raportit Publik” të publikuar nga AKP, u bënë publike të dhënat e Maturës Shtetërore 2014 për institucionet qendrore dhe për publikun e gjerë, të interesuar për këto rezultate.

### **Provimet e Shtetit:**

- ✓ Vënia në gatishmëri e infrastrukturës së zhvillimit të provimeve.
- ✓ Koordinimi me MAS për plotësimin me numrin e duhur të anëtarë të komisioneve.

- ✓ Njoftimi i komisioneve të profesioneve me grafikun e zhvillimit të provimeve.
- ✓ Marrja e listave të kandidatëve nga urdhrat profesionalë dhe shpallja e tyre në faqen zyrtare të agjencisë.
- ✓ Përpunimi përfundimtar i listave të kandidatëve mësues të ardhur nga DAR/ZA të duke evidentuar pjesëmarrjen për çdo profil mësuesi.
- ✓ Publikimi i programeve dhe fondit të pyetjeve për çdo profesion.
- ✓ Publikimi i grafikut të provimeve të shtetit në sesionin përkatës.
- ✓ Organizimi i shërbimit të pranimit të kandidatëve në sallat e provimit.
- ✓ Printimi i deklaratave personale të kandidatëve për çdo seancë provimi.
- ✓ Arkivimi i rezultateve të kandidatëve.
- ✓ Shqyrtimi dhe përgjigja e rasteve të ankmuara.
- ✓ Dërgimi i rezultateve të kandidatëve urdhrave të profesioneve.

Sesioni i Provimeve të Shtetit për tre nen profesionet e reja u zhvillua për herë të parë me datë 28 shkurt në Imazheri e Logopedi dhe me datë 1 Mars në profesionin Teknik Laboratori.

Përcaktimi në bashkëpunim me Rektorët e IAL-ve i grupeve të hartuesve të pyetjeve për tre profesionet shitesë në mësuesi; gjuhë gjermane, gjuhë greke dhe Arsim Fillor klasa 1-6.

Zhvillimi i provimeve të shtetit në fushën e mjekësisë për profesionet dhe nën profesionet fushës së mjekësisë; Mjekësi e përgjithshme, Stomatologji, Farmaci, Infermieri e përgjithshme, Mami, Fizioterapi, Imazheri, Logopedi dhe Teknik Laboratori.

#### **Vlerësimi Ndërkombëtar PISA 2015:**

- ✓ Përgatitja e të dhënave për realizimin e Field Trail, PISA 2015 (prill 2014).
- ✓ Pjesëmarrja në trajnimet periodike vjetore të PISA 2015.
- ✓ Dërgimi i të dhënave dhe plotësimi i formularëve të target popullatës që do të vlerësohej.
- ✓ Përgatitja e të dhënave për kampionimin e shkollave dhe nxënësve në ato shkolla.
- ✓ Përkthimi dhe përshtatja e materialeve.
- ✓ Miratimi i materialeve në Westat, Capstan dhe ACER.

#### **Pranimet IAL online:**

Pranimet në IAL publike për vitin 2014 u bënë në sistem online.

Plotësimi i formularit A2 u realizua online në një sistem që ofronte informacion dhe këshillim për studentët.

Regjistrimi i fituesve në IAL u realizua online. Kandidatit fitues nuk iu kërkua të dorëzojë diplomën e maturës shtetërore pranë sekretarisë së IAL-së përkatëse.

- ✓ Vënia në gatishmëri e portalit matuara.akp.gov.al për plotësimin nga kudo të formularit A2.
- ✓ Trajnimi i punonjësve për çdo DAR/ZA.
- ✓ Plotësimi me të gjitha të dhënat e nevojshme të formularit A2 (lista e universiteteve, programeve të studimit, kuotave, koeficienteve).

#### **Randi I:**

- ✓ Plotësimi on line i formularit A2.

- ✓ Shpallja e fituesve për secilin program studimi.
- ✓ Dërgimi zyrtar i listave të fituesve çdo universiteti sipas çdo fakulteti.
- ✓ Regjistrimi online i fituesve në universitete, raundi I.
- ✓ Marrja nga universitetet të listave për vijimin ose jo të studimeve nga çdo student i regjistruar.
- ✓ Evidentimi i kuotave të paplotësuara na IAL publike.

### **Raundi II:**

- ✓ Publikimi I formularit A3 së bashku me VKM dhe urdhrat e Ministrit të Arsimit që rregullojnë plotësimin e formularit për pranimet në IAL në raundin e dytë.
- ✓ Pasqyrimi në modulën e aplikimit online të procedurave të miratuara të plotësimit të A3
- ✓ Prezantimi në medianë e shkruar dhe vizive i procesit dhe i ndryshimeve të ndodhura krahasuar me vitet e mëparshme.
- ✓ Plotësimi online i formularit A3 dhe shpallja e fituesve
- ✓ Marrja nga IAL të listave për vijimin ose jo të studimeve nga çdo student fitues i raundit II.

### **Shërbime për pranimet në IAL – publike /part-time dhe private:**

- ✓ Pranimi i kërkesave të kandidatëve që duan të vazhdojnë IAL publike dhe private .
- ✓ Pajisja me dokumentacionin përkatës të studentëve sipas udhëzimit të Ministres së Arsimit dhe Sportit nr.47,datë 29.08.2013”Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të pjeshme dhe edukimin në distancë, në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë në vitin akademik 2013-2014”.
- ✓ Mirëmbajtja e të dhënave.
- ✓ Publikimi i akteve zyrtare që rregullojnë pranimet për IAL private dhe publike part/time për vitin akademik 2013 – 2014.

### **Regjistri kombëtar i studentëve:**

- ✓ Plotësimi i të dhënave në formatin e duhur për marrjen e numrit NIM.
- ✓ Mirëmbajtja e infrastrukturës të shkëmbimit të informacionit me universitetet.
- ✓ Plotësimi i regjistrit kombëtar të studentëve që u regjistruan për herë të parë dhe vijuan vitin akademik 2014-2015 në programet e studimit cikli I, cikli II dhe cikli III në të gjitha IAL(publike dhe private).
- ✓ Mirëmbajtja e data bazave dhe hartimi i raporteve mbi të dhënat.

### **Provimi i lirimimit 2014:**

- ✓ U hartuan testet e sesionit I & sesionit II të provimeve të lirimimit në lëndët letërsi dhe gjuhë shqipe dhe matematikë të shoqëruara me skemat përkatëse të vlerësimit.
- ✓ U monitorua dita e zhvillimit të provimit të lirimimit në datat përkatëse sipas lëndëve.

### **Olimpiadat kombëtare 2014:**

- ✓ Hartimi i testeve të olimpiadave kombëtare, faza e dytë.

- ✓ Vlerësimi me pikë i përgjigjeve të nxënësve të fazës së tretë.
- ✓ Nxjerrja e rezultateve dhe dërgimi i tyre në MAS.
- ✓ Përgjigje rasteve të ankimuara.

#### **Vlerësimi kombëtar klasa e tretë dhe e pestë:**

- ✓ Përzgjedhja e kampionit me bazë shkolle.
- ✓ Përzgjedhja e nxënësve brenda shkollës.
- ✓ Ngritja e grupeve të hartuesve të testeve.
- ✓ Caktimi dhe trajnimi i vlerësuesve të testeve.
- ✓ Vlerësimi i testeve .
- ✓ Hedhja në kompjuter e të dhënave të vlerësimit.
- ✓ Përgatitja e raporteve dhe përcjellja e tyre në MAS.

#### **Komente:**

- ✓ Të gjitha arritjet e sipërpërmendura janë realizuar nga AKP dhe bashkëpunëtorët e saj, (pedagog, mësues, specialistë e operator ekonomik) detyrimi ndaj të cilëve, për vitin 2014 është likuiduar plotësisht.
- ✓ Shuma e detyrimeve të trashëguara të AKP në datën 31.12.2013 kapin shumën 67.487.174 lekë, në të cilën rreth 91% e tyre janë detyrime për aktivitetet e realizuara në vitin 2013, dhe 9% janë detyrime për aktivitetet e realizuara në vitin 2012.
- ✓ Të shihet mundësia e shtesës së fondeve për vitin 2015 nga buxheti i shtetit dhe të na lejohet përdorimi i të ardhurave të krijuara sipas VKM nr.810, datë 10.11.2011 "Për përcaktimin e tarifave për provimet e shtetit".
- ✓ Të shihet mundësia e parashikimit të fondeve për përmirësimin e aftësive profesionale të punonjësve të AKP-së nëpërmjet formimit profesional dhe trajnimeve të vazhdueshme të financuara nga fondet publike.
- ✓ Të shihet mundësia e parashikimit të fondeve të veçanta për përmirësimin e kapaciteteve teknike që kanë të bëjnë me pajisjet materiale dhe softet kompjuterike që përdoren për realizimin e detyrave të agjencisë.

#### **Risqe të parashikuara lidhur me realizimin e objektivave të vitit 2015:**

Risku i brendshëm për formalizimin e procedurave për menaxhimin e riskut.

Risku i jashtëm për sigurimin e burimeve të ndryshme të financimit për arritjen e objektivave.

#### **Niveli i rëndësisë së riskut (nga 1-prioritet maksimal në 3-minimal)**

3

### **Masat që parashikohen ose që kërkohen për minimizimin e risqeve:**

Risku i brendshëm për formalizimin e procedurave për menaxhimin e riskut. Në vitin 2014 janë miratuar me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, statuti dhe rregullorja e brendshme e institucionit që rregullon të gjithë veprimtarinë e institucionit. Gjithashtu me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AKP-së janë miratuar Rregullorja e brendshme “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, Rregullorja e brendshme “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe Rregullorja “Për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm.

Risku i jashtëm për sigurimin e burimeve të ndryshme të financimit për arritjen e objektivave. Sigurimi i formave alternative të financimit nëpërmjet organizatave të ndryshme.